

BAHRI BECI

## GJURMIMI I TË FOLMEVE QENDRORE TË DIALEKTIT TË VERIUT

(Rezultate dhe probleme)

1. Gjuhësia shqiptare e pasçlirimit, në kuadrin e përgjithshëm të studimit të dialekteve të shqipes, ka arritur rezultate të rëndësishme edhe në gjurmimin e të folmeve qendrore të dialektit të veriut. Të folmet qendrore të dialektit të veriut shtrihen nga Drini e Malet e Sharrit në veri, deri në Malësinë e Tiranës, Martanesh e Çermenikë në jug. Këtu bëjnë pjesë të folmet e Fushë Krujës, Mirditës, Matit, Lumës, Dibrës dhe të folmet e krahinave veriperëndimore të Maqedonisë së sotme (të Tetovës, të Gostivarit, të Rekës dhe të rretheve të Shkupit).

Në këtë artikull, në mënyrë të përmbledhur, do të parashtrojmë gjendjen e gjurmimeve dhe të studimeve për këto të folme, disa nga rezultatet e arritura si dhe detyrat që dalin për të ardhmen.

Rezultatet e arritura në gjurmimin e këtyre të folmeve paraqesin interes për arsye se këto kanë një sërë fenomenesh gjuhësore të veçanta dhe mjaft tipike. Në këtë zonë gërshetohen mjaft fenomene dialektore karakteristike për nëndialektet dhe grupet e ndryshme të të folmeve të dialektit të veriut, duke u ndërthurur mjaft izoglosa. Në të kalonte edhe kufiri që ndante dy nga principatat më të mëdha feudale të mesjetës, principatën e Kastriotëve nga ajo e Dukagjinasve.

2. Gjurmimi dhe studimi i të folmeve qendrore të dialektit të veriut ka nisur në fillim të shek. XX. Ai ka kaluar në dy faza. Faza e parë përfshin kryesisht periudhën para çlirimit, kurse faza e dytë periudhën pas çlirimit.

Këto dy faza nuk mund të ndahen me kufij kohorë tepër të prerë, meqenëse edhe në periudhën pas vitit 1944 ndeshemi me punime, të cilat në thelb përshkohen nga karakteristikat themelore të fazës së parë.

Ajo që kemi trashëguar nga faza e parë e kërkimeve në të folmet e këtij territori është relativisht e varfër.

Gjatë viteve 1915-1941 nga autorë të huaj si N. Jokli, M. Lambertzi, S. Mladenovi, P. Skoku dhe vendës si A. Imami e Shteku (nga Luma) u botuan relacione ose shënime të shkurtëra mbi disa nga veçoritë kryesore fonetike të të folmeve të fshatit Rapshisht, të Mirditës, të Kaçanikut, të Kumanovës, të Tetovës, të Gostivarit, të Dibrës, të Shkupit dhe të Lumës.<sup>1</sup>

1) Duhet shënuar se për ndonjë tipar karakteristik të të folmeve të Matit e të Dibrës është bërë fjalë që më 1867 nga J. G. Hahn, (shih J. G. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*, Denkschriften d. Akad. d. Wiss. in Wien, Phil. — hist. Kl., Bd. 15, Wien, 1867, f. 82).

N. Jokl, *Vorläufiger Bericht über die im Auftrag der Balkan-Kommission der*

Më 1942 K. Taliavini botoi punimin «Të folmet e shqipës të tipit geg-lindor (Dardania dhe Maqedonia veriperëndimore)»<sup>2</sup>, në të cilin jepet një pasqyrë e përmbledhur e disa veçorive fonetike, të ndonjë veçorie morfologjike dhe ndonjë shënim për veçoritë leksikore të të folmeve që ai i quan gege-lindore e që përfshijnë edhe një pjesë të mirë të të folmeve qendrore të dialektit të veriut.

Sikundër shënonte edhe vetë autori, ky punim mbështetej në materiale të botuara, të cilat ishin të pakta dhe me vlerë të ndryshme. Ky punim megjithatë ka vlerë për njohjen e disa prej veçorive fonetike të të folmeve qendrore të dialektit të veriut.

Në njohjen e këtyre të folmeve në këtë fazë ka ndihmuar sado pak edhe botimi i materialeve leksikore<sup>3</sup> e folklorike të mbledhura në këtë territor. Përsa u përket materialeve folklorike, duhen dalluar nga njëra anë materialet e mbledhura nga specialistë me qëllime dialektologjike dhe folkloristike dhe, nga ana tjetër, materialet e mbledhura nga njerëz të dhënë pas folklorit me qëllime thjesht folkloristike.

Në grupin e parë bëjnë pjesë pak tekste të botuara nga G. Majeri e M. Lamberti, me një vlerë më pak të sigurtë edhe disa materiale të botuara nga H. Stërmilli e ndonjë tjetër<sup>4</sup>.

Materialet folklorike të tipit të dytë, meqenëse nuk janë regjistruar në përputhje me kërkesat e regjistrimit të materialeve dialektore, nuk mund të shërbejnë si një burim i sigurtë për njohjen e të folmeve qendrore të dialektit të veriut.

Sipas nesh, kjo fazë e gjurmimit dhe e studimit të të folmeve qendrore të dialektit të veriut ka këto karakteristika themelore: 1) gjurmimi dhe studimi i këtyre të folmeve bëhet në mënyrë jo sistematike; 2) gjurmimet dhe studimet nuk rrokin gjithë sistemin fonetik, morfologjik, sin-

*Kais. Akad. der Wiss. in Wien durchgeführten nordostgegischen Dialektstudien, Anzeiger, d. k. Ak. d. Wiss. Wien, Phil. — hist. Kl.; 52 (1915):*

M. Lambert, *Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916. Anzeiger d.k.Ak. d. Wiss. Wien, Phil. — hist. Kl. 1916, XX.*

S. Mladenov, *Bemerkungen über die Albaner und das Albanische in Nordmakedonien und Altserbien, Balkan-Archiv, I, 1925, f. 43-70.*

A. Imami, *Disa trajta dialektore të krahinës së Dibrës*, në «Edukata e Re», 1930, 3, f. 106-107, 1930, 12, f. 468-469.

Shteku (nga Luma), *Vrejtje dialektesh*, në «Edukata e Re» 1931, 1, 16.

J. Rrota, *Letratyrja shqype*, 1934, f. 19.

P. Skok, *Lingvistička Proučavenja neslovenskog stanovništva Skopske kotline*, në «Godisnjak Muzeja Južne Srbije», I, 1941, f. 209-230.

2) C. Tagliavini, *Le parlate albanesi di tipo ghego orientale (Dardania e Maqedonia nord-occidentale)*, në «Le terre albanese redente», I, Cosovo, Roma, 1942, f. 1-80.

3) *Edukata e Re*, 1930, Nr. 1, f. 36; Nr. 4, f. 157; Nr. 5, f. 208; Nr. 6, f. 240; Nr. 8-9, f. 337-340; Nr. 10, f. 394; 1931 Nr. 1, f. 23; Nr. 4, f. 117; *Folklorë*, vëll. I, 1939; *Cirka*, Vj: 4, nr. 56-57; 29 kallnor 1939, f. 16; Vj. II, nr. 24, 20 qershor 1937, f. 148, Vj II, nr. 25, 4 korrik 1937, f. 159; Vj. II, Nr. 26, 18 korrik 1937, f. 178; Vj. II, Nr: 27, 1 gusht 1937, f. 191; Vj. II, nr. 28-29, 5 shtatuer 1937, f. 217; Vj. II nr. 31, 3 tetor 1937.

4) G. Meyer, *Albanesische Studien, VI, 1897 (shih edhe «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar 1635-1912»*, I, f. 499).

M. Lambert, *Albanische Märchen*, Akad. d. Wiss. in Wien, Schriften der Balkankommission, Linguist, Abt. XII, Wien, 1922, f. 191-196, 245-248.

P. Suli, *Hylli i Dritës*, 1930, f. 239-244; *Leka*, 1930, 3, f. 83-86; 1935, 52-53; 1943, f. 123.

M. Kola, *Cirka*, Vj. II, Nr. 25, 4 korrik 1937, f. 164; *Cirka*, Vj. III, Nr. 38, 3 kallner 1938, f. 23.

H. Stërmilli, *Fyelli i Dibrës*, në «Visaret e Kombit», vll. XIV, Tiranë 1944.

taksor e leksikor të këtyre të folmeve; 3) metodika e parashtrimit të veçorive të këtyre të folmeve nuk është unike.

Kontributi i kërkimeve të kësaj etape qëndron më së forti në sinjalizimin e disa veçorive fonetike të këtyre të folmeve dhe të ndonjë veçorie morfologjike.

3. Faza e dytë e gjurmimit dhe e studimit të të folmeve qendrore të dialektit të veriut fillon pas çlirimit të atdheut tonë dhe të vendosjes së pushtetit popullor.

Në fillimet e kësaj faze u zgjidhën disa probleme të përgjithshme me karakter organizativ-shkencor që çelën rrugën edhe për gjurmimin e këtyre të folmeve. Nër këtë duhet përmendur: hartimi i dy pyetësorëve për mbledhje materialesh dialektore respektivisht nga M. Domi, e E. Çabej dhe S. Floqi<sup>5</sup>, të cilët shërbyen si pikëmbështetje edhe për gjurmimin dhe studimin e të folmeve qendrore të dialektit të veriut.

Duke filluar nga vitet pesëdhjetë, në kuadrin e përgjithshëm të kërkimeve dialektologjike, nisi një punë sistematike dhe e organizuar edhe për grumbullimin e materialeve dhe studimin e këtyre të folmeve. Nga dialektologët tanë u mbledhën materiale në më se 60 fshatra, në zonën e këtyre të folmeve që shtrihet brenda kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë.

U hartuan monografi respektivisht për të folmet e Matit, Lurës, Reç-e-Dardhës, Krujës dhe Malësisë së saj, Grykës së Madhe të Dibrës, Luznisë së Dibrës, Mirditës dhe Kalisit të Lumës<sup>6</sup>.

U bënë vëzhgime dhe u hartuan përshkrime për disa nga fenomenet më karakteristike të këtyre të folmeve, si për diftongimin e *i*-së së theksuar, palatalizimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *tj*, *dj* respektivisht në *q*, *gj*, të *g*-së në *gj*, për delabializimin e *y*-së në *i* dhe diftongimin e kësaj të fundit në diftongje sekondare, si edhe për kalimin e *y*-së në *ö* dhe *Ø*.<sup>7</sup>

Kjo fazë e gjurmimit dhe e studimit të të folmeve qendrore të dialektit të veriut karakterizohet: 1) nga gjurmime sistematike dhe të organizuara; 2) studimet e kryera rokin sistemin fonetik, morfologjik, sintaktik e leksikor të këtyre të folmeve, 3) metodika e parashtrimit të veçorive të këtyre të folmeve është unike.

5) M. Domi — E. Çabej, *Kuestionar dialektologjik* (I Kuestionar i përgjithshëm; II Kuestionar i veçantë), Tiranë 1953, botuar pa emër autori nga M. Lambertz në *Lehergang des albanischen*, III, Halle 1959, f. 53-58. Pyetësori i përgatitur nga S. Floqi nuk është botuar, po në krahasim me pyetësorin e M. Domit e E. Çabejt është më i gjerë (ka 304 pyetje për fonetikën, morfologjinë, sintaksën dhe leksikun).

6) B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT SSHSH 2, 1962, f. 208-248; 3, 1963 f. 257-277; K. Ulqini, *Disa vëzhgime mbi të folmen e Matit*, BUSHT SSHSH, 3, 1961, f. 195-219; A. Çefa, *Një vëshirim mbi të folmen e krahinës së Prellit*, «Buletin i Institutit të Naltë Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës», 1957, 1, 10-36.

7) Q. Haxhihasani, *Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës*, BUSHT, SSHSH, 4, 1963, f. 116-164.

B. Beci, *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, «St. fil.», 4, 1964, f. 135-159; 1, 1965, f. 79-100.

J. Gjinari, *Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe të Malësisë së Krujës*, «St. fil.», 3, 1964, f. 91-105; 4, 1964, f. 117-133.

B. Beci, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës (punim i pabotuar)*; *E folmja e Luznisë së Dibrës (punim i pabotuar)*; *E folmja e Mirditës (punim i pabotuar)*.

Sh. Hoxha, *E folmja e Kalisit të Lumës (punim i pabotuar)*.

7) B. Beci, *Mbi katër inovacione fonetike të të folmeve të Gegënisë së Mesme*, «Konf. e parë e st. albanologjike», Tiranë 1965, f. 261-270; *Mbi zhvillimet e fonemës y në të folmet e shqipes*, «Konferenca e dytë e studimeve albanologjike (12-18 janar 1968)», III, Tiranë, 1969, f. 253-259.

Duhet shënuar se gjatë kësaj faze u botuan edhe disa punime dialektore jashtë vendit tonë për të folmen e Zajazit, Kerçovës, për fonetikën e së folmes së Dervendit të Tetovës, për veçoritë e sistemit të bashkëtingëlloreve të së folmes së Kaçanikut, për vetitë tingëllore të së folmes së Dibrës, për sistemin morfologjik të së folmes së Krujës.<sup>8</sup>

Nga këto, dy punimet e fundit nuk mund të konsiderohen si burime me vlerë të plotë për këto të folme, sepse materialet e parashtruara nuk i janë nënshtruar asnjë verifikimi në terren; i pari është mbështetur në një përmbledhje këngësh popullore të Dibrës<sup>9</sup>, kurse i dyti në vetvrotimin e autorit, i cili vetëm 12 vjetët e parë të jetës së tij i ka kaluar në Krujë.

Punimet e botuara për të folmet e Zajazit, Kaçanikut, Kerçovës dhe Dervendit janë një kontribut pozitiv për njohjen, sidomos, të veçorive fonetike të këtyre të folmeve, meqenëse janë mbështetur në vrojttime të drejtpërdrejtë në terren e kanë materiale me interes.

4. Cilat janë rezultatet kryesore që u shënuan tek ne gjatë fazës së dytë të studimit të këtyre të folmeve?

Detyra themelore, që u shtrua gjatë kësaj faze për të folmet e shqipes në përgjithësi dhe të folmet qendrore të dialektit të veriut në veçanti, ishte «*vëzhgimi i përgjithshëm në gjerësi i veçorive të dialekteve e të folmeve të shqipes, përcaktimi i kufijve të tyre dhe përshkrimi i fenomeneve më pak të njohura*»<sup>10</sup>, detyrë që u plotësua me sukses.

a. Rezultati kryesor në gjurmimin e këtyre të folmeve pas çlirimit është grumbullimi i një materiali të pasur, i cili lejon zbulimin e veçorive dialektore të këtyre të folmeve dhe përcaktimin e shtrirjes territoriale të tyre. Duhet shtuar se për të folmet që shtrihen në Maqedoninë veriperëndimore jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë, materialet janë të pamjaftueshëm.

Konkretisht gjatë kësaj faze u vërtetua se këto të folme karakterizohen nga disa fenomene specifike që rrokin shumicën ose të gjithë të folmet qendrore të dialektit të veriut, siç janë për shembull diftongimi i *i*-së së theksuar në diftongjet sekondarë: *ai, oi, ei, ëi* etj., delabializimi i *y*-së në *i* dhe diftongimi i kësaj të fundit në diftongje sekondare, kalimi i *y*-së në *ō* ose *Ø*, palatalizimi i grykores *g* në palatalen *gj*, palatalizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *tj, dj*, respektivisht me *q, gj* etj. Doli gjithashtu se disa fenomene si kalimi i *a*-së e *o*-së gojore respektivisht në *ā* e *ō* (tinguj më të përparmë), i grupit të bashkëtingëlloreve *mj* në *nj* janë përhapur kryesisht në pjesën qendrore të territorit të këtyre të folmeve. U vërtetua se fenomene të tilla si diftongimi i *u*-së së theksuar në *au, ou*, palatalizimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *pl, bl, fl* respek-

8) A. Selimi, *Të folmet e Zajazit me disa karakteristika*, «Përparimi» 6, 1961.

B. Hysa, *Veçoritë e bashkëtingëlloreve në të folurit e Kaçanikut*, «Përparimi», 3, 1963.

A. Zenku, *Disa karakteristika të së folmes në krahinën e Kerçovës*, «Jehona», Shkup, 3, 1968.

I. Hyseni, *Karakteristikat fonetike të së folmes së Dervendit të Tetovës*, «Jehona», Shkup, 6, 1968.

Gl. Elezović, *Glasovne osobine arbanaškog dijalekta Debra i njegove okoline*, «Dija lektološki Zbornik», knj. XI Beograd 1950.

D. Berberi, *Verb morphology of the Albanien Dialect of Kruja*, Indiana University, M.S., Thesis, 1963.

9) H. Stërmilli, *Fyelli i Dibrës*, në «Visaret e Kombit», vll. XIV, Tiranë 1944.

10) A. Kostallari, *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri. Probleme dhe detyra të reja*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», 1965, f. 45.

tivisht në *pj* (*q, ç*), *bj*, (*gj, xh*), *fj* (*q, ç*) e ndonjë tjetër janë përhapur në viset lindore të territorit të këtyre të folmeve.

U vu re se kjo zonë përshkohet nga një numër fenomenesh karakteristike për nëndialektet dhe grupet e ndryshme të të folmeve të dialektit të veriut, si edhe se ka pika kontakti të këtyre të folmeve me të folmet jugore të dialektit të veriut dhe të folmeve veriore të dialektit të jugut.

Duhet pranuar se në këtë drejtim nuk janë kryer studime përgjithësuese, të cilat pa dyshim do të ishin një kontribut i rëndësishëm për zbulimin e marrëdhënjëve të këtyre të folmeve me të folmet për rreth. Këto studime do të kontribuonin edhe në përcaktimin e argumentimin e mëtejshëm të vendit të këtyre të folmeve në të folmet e dialektit të veriut.

Vëmendja kryesore gjatë gjurmimit dhe studimit të këtyre të folmeve është përqëndruar në përshkrimin e tipareve fonetike, meqenëse në këtë fushë këto të folme paraqiten me më shumë inovacione.

Po pikërisht në këtë fushë studjuesit janë ndeshur me vështirësi, të cilat vetëm pjesërisht mund të thuhet se janë kapërcyer.

Kështu, për shembull, në qoftë se në përcaktimin e shtrirjes territoriale të fenomenit të diftongimit të *i-së* së theksuar dhe të varianteve të saj janë arritur rezultate, duhet pranuar se në përshkrimin e veçorive akustike e fiziologjike të këtyre varianteve mbetet ende mjaft punë për t'u kryer. Në përgjithësi përshkrimi i veçorive akustike e fiziologjike të tingujve mjaft karakteristikë të këtyre të folmeve nuk i është nënshtruar akoma një metodë eksperimental-fonetike. Nuk janë bërë përpjekje për të caktuar me saktësi vlerën fonologjike të tingujve karakteristikë të këtyre të folmeve.

Një vëmendje e rëndësishme i është kushtuar edhe zbulimit të veçorive morfologjike të këtyre të folmeve. Problemet e fjalëformimit të sintaksës dhe të leksikut kanë zënë një vend të vogël.

b. Në anë tjetër janë bërë përpjekje dhe janë arritur rezultate në përcaktimin e vendit të këtyre të folmeve në mes të të folmeve të shqipes.

Me gjithë ndryshimet që vihen re në mendimet lidhur me vendin e këtyre të folmeve në të folmet e shqipes dhe lidhur me shtrirjen e tyre territoriale, mendojmë se ekziston një mendim i përbashkët më i përgjithshëm që i veçon këto të folme si një grup më vete që u kundërvihet grupeve të tjera të të folmeve të shqipes.<sup>11</sup>

Janë bërë përpjekje dhe janë arritur rezultate edhe në përcaktimin e veçorive dalluese fonetike që i bashkojnë këto të folme në një grup më vete, që u kundërvihet grupeve të tjera të të folmeve<sup>12</sup>, kurse kanë munguar përpjekjet për të zbuluar veçoritë dalluese morfologjike, leksikore e sintaksore të këtyre të folmeve.

c. Duke filluar nga vitet pesëdhjetë janë shënuar rezultate edhe në studimin e historisë së disa prej fenomeneve të dialektit të veriut, që janë karakteristike edhe për këto të folme<sup>13</sup>. Është bërë objekt studi-

11) M. Lambertz, *Bericht...* f. 9; *Die Mundarten der Albanischen Sprache und ihre Erforschung, Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa*, Bd. 7, H. 2-4, 1943, f. 129; B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSHT, SSHSH 1962, 2, 248; *Mbi katër inovacione...* f. 261; J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, 1963, f. 76-77-78; J. Gjinari, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*. «St. fil.», 1966, 4, f. 108-110; A. V. Desnickaja, *Albanskiy jazyk i evo dialekty*, Leningrad, 1968, 149. Për këtë shih edhe M. Çeliku, *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*, «St. fil.», 1968, 3, 124.

12) B. Beci, *Mbi katër...*, 261-269.

J. Gjinari, *Dialektologjia...*, f. 78; *Sprovë...*, f. 113

mi edhe historia e disa fenomeneve dialektore tipike të këtyre të folmeve, të bazuara në analizën e një materiali faktik të mjaftueshëm të mbledhur në këto të folme gjatë fazës së dytë.

Është trajtuar historia e lindjes së katër prej fenomeneve karakteristike të këtyre të folmeve siç janë: diftongimi i *i*-së së theksuar, palatalizimi i bashkëtingëllores grykore *g* në *gj*, i grupeve të bashkëtingëlloreve *tj*, *dj* respektivisht në *q*, *gj*,<sup>14</sup> si edhe historia e delabializimit të *y*-së në *i* në këto të folme.<sup>15</sup>

5. Siç shihet, në fazën e pasqirimit u zgjidhën disa nga detyrat më themelore që shtronte studimi i këtyre të folmeve dhe u përcaktuan qartë detyrat për të ardhmen, ndër të cilat do të përmendim më themeloret.

Puna e parë që duhet kryer është hartimi i një punimi përshkrues përgjithësues-sintetizues mbi veçoritë fonetike, morfologjike, leksikore dhe sintaksore të këtyre të folmeve. Në këtë drejtim është bërë një punë pregtitore e gjerë, e cila do të lejojë të përshkruhen në mënyrë sistematike e deri diku tërësore në një punim të vetëm tiparet themelore karakteristike të këtyre të folmeve, shka do të shërbejë si një bazë e shëndoshë për sqarimin e shumë problemeve që shtron studimi i këtyre të folmeve.

Realizimi i kësaj detyre do të kërkojë nga ana tjetër zgjerimin e mëtejshëm të kërkimeve në terren dhe hartimin e studimeve për probleme të veçanta të fonetikës, morfologjisë, leksikut dhe sintaksës. Punime të tilla janë ndërmarrë për disa nga fenomenet fonetike më karakteristike të këtyre të folmeve, po ato duhen shtrirë edhe në fushën e morfologjisë së leksikut e të sintaksës.

Marrëdhënjet e këtyre të folmeve me të folmet për rreth përbëjnë një fushë të gjërë kërkimesh që do të lejojë të sqarohen dhe të vihen në pah më drejt tiparet e këtyre të folmeve në tërësinë e dialektit të veriut dhe do të kontribuonin në përcaktimin dhe argumentimin e mëtejshëm të vendit të këtyre të folmeve në të folmet e shqipes.

Një problem tjetër, i cili është trajtuar kalimthi dhe që meriton të bëhet objekt studimesh të veçanta, është edhe ai i marrëdhënjeve të të folmeve periferike të këtij grupi të folmesh me të folmet fqinjë maqedone.<sup>16</sup> Vënja në dukje, nga njëra anë, e ndikimeve të maqedonishtes mbi këto të folme dhe, nga ana tjetër, e këtyre të folmeve mbi të folmet maqedone është një detyrë që duhet kryer dhe me interes jo vetëm për gjuhësinë por edhe për historinë e marrëdhënjeve gjuhësore shqiptaro-sllave në përgjithësi.

Një problem që duhet zgjidhur në të ardhmen është edhe krijimi i fonotekës së këtyre të folmeve në kuadrin e fonotekës së dialekteve të shqipes, studimi eksperimental i tingujve më karakteristikë të këtyre të folmeve dhe përcaktimi i vlerës fonologjike të tyre.

Një aspekt tjetër me rëndësi i studimit të këtyre të folmeve që pret zgjidhje është edhe gjurmimi dhe studimi i ndikimeve të gjuhës letrare mbi këtë grup të folmesh.

13) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, BSHSH, 1955, 2, f. 86, 87, 88, 90, 92-93, 95, 97-98; *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, BUSHT, SSHSH, 1958, 1, f. 33, 35, 47, 64-65; *Diftongje e grupe zanoresh të shqipes*, BUSHT SSHSH, 1958, 3, f. 77.

14) E. Beci, *Mbi katër...*, f. 264-267.

15) B. Beci, *Rreth kronologjisë dhe shkaqeve historike që kanë përcaktuar kalimin e y-së në i në Gegëri të Mesme*, «Kongresi i Manastirit», Shkodër, 1969, f. 57-65.

16) E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe (dispensë)*, Tiranë, 1960, 61.

Ndriçimi i të gjitha këtyre problemeve do të pasurojë dijen tonë në këtë fushë kërkimesh, që përbën një pjesë të tërësisë së studimeve tona dialektore që në kohën tonë ruajnë një vlerë të paçmuar në ndriçimin e problemeve të strukturës së shqipes së sotme e të zhvillimit të saj historik.

### Résumé

#### RECHERCHES SUR LES PARLERS CENTRAUX DU DIALECTE SEPTENTRIONAL

Dans son exposé, l'auteur ébauche les résultats obtenus dans les recherches et les études sur les parlers centraux du dialecte septentrional dans la période d'avant la libération du pays. Ces parlers comprennent la zone de Fushë Kruje, Mirdite, Mati, Lume et Dibra et les contrées N. — O. de la Macédoine actuelle.

L'auteur fait observer que la recherche et l'étude des parlers centraux du dialecte septentrional a commencé au début du XX<sup>e</sup> siècle et a passé par deux phases. La première comprend surtout la période d'avant la libération; la deuxième, celle d'après la libération du pays.

A l'avis de l'auteur, la première phase de recherches et d'études de ces parlers peut être rapportée aux caractéristiques fondamentales suivantes: 1. La recherche et l'étude de ces parlers a lieu d'une façon nullement systématique; 2. Les études ne saisissent pas la totalité des systèmes phonétique, morphologique, syntaxique et lexical de ces parlers; 3. La méthode d'exposition de ces parlers n'est pas unique.

L'auteur considère que la contribution des recherches de la première phase réside surtout dans la signalisation de quelques particularités phonétiques de ces parlers et de quelque trait morphologique.

La deuxième phase, à différence de la première, commence après l'instauration du pouvoir populaire. Elle a les caractéristiques suivantes: 1. La recherche et l'étude de ces parlers a lieu d'une façon systématique; 2. Les études effectuées embrassent ces parlers en tant que systèmes; 3. La méthodique d'exposition de ces parlers est unique.

Durant la deuxième phase ont été glanés des matériaux dans plus de 60 agglomérations rurales des parlers centraux du dialecte septentrional. Des monographies ont été ainsi réalisées sur les parlers de Mati, Lure, Reç-e-Dardhe, Kruje et sa Mallesie, Grykemadhe de la Dibra, Luznie de la Dibra, Mirdite et Kalis de Lume.

Des descriptions ont été faites sur plusieurs des phénomènes les plus caractéristiques de ces parlers.

Les principaux résultats acquis dans la période d'après la libération du pays dans l'étude de ces parlers, sont, suivant l'auteur: 1. un matériel riche qui permet de mettre au clair les particularités dialectales de ces parlers, ainsi qu'à fixer leur extension territoriale; 2. la réalisation d'une conception plus générale qui isole ces parlers comme un groupe à part qui s'oppose aux autres groupes des parlers de l'albanais; 3. la mise en évidence de l'histoire de quelques-uns des phénomènes dialectaux caractéristiques à ces parlers.

Dans l'article ci-contre l'auteur expose aussi quelques-unes des tâches fondamentales à étudier ces parlers dans un proche avenir.

La réalisation de ces tâches enrichira nos renseignements dans ce domaine de recherches, qui constitue une partie de la totalité des études dialectales albanaises. Et cela est en rapports étroits avec la valeur indiscutable qu'ont ces parlers à mettre au clair les problèmes de la structure de l'albanais contemporain et de leur développement historique.

